

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trajneri Maran para ndeshjes me Bjellorusinë: I kam idetë e qarta për lojtarët, do të bëjnë më të mirën - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/trajneri-maran-para-ndeshjes-me-bjellorusine-i-kam-idete-e-qarta-per-lojtaret-do-te-bejne-me-te-miren/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 13:57:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 13:55:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dc4f4b5217fcc6b7c5e7d9807cfb3ed3f557521df9eb01c55622a05459e8f588
TEKSTI	b8757ce24299497263a6b537333e2a5dd10d1c611ec6fd93a7b107b1fc54ec2c
PAMJA	f10c12166984ed78cd2719351aa394d96ebdc03a59dc1b6b3a7559327c11eb06

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fbabeb0448cc8636f75d4152b9d73cf80f81e43d2a3f3c4e03d9dde70f534950
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fbabeb0448cc8636f75d4152b9d73cf80f81e43d2a3f3c4e03d9dde70f534950>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Kosova Reforma Territoriale Vlora Hyseni Donald Trump

SPORT

Trajneri Maran para ndeshjes me Bjellorusinë: I kam idetë e qarta për lojtarët, do të bëjnë më të mirën



25 Shtator 2026 | 15:55

Trajneri i kombëtares shqiptare, Rolando Maran, këtë të premte doli në një konferencë për mediat në prag të ndeshjes kundër Bjellorusisë. Tekniku italian shprehu emocionin për këtë sfidë, ndërsa konfirmoi se ka pasur disa problematika fizike me lojtarët gjatë grumbullimit.

Pavarësisht pengesave të vogla, Maran theksoi se ekipi është gati dhe me motivim maksimal. Ai u shpreh se kushdo që do të marrë minuta në fushë, e di mirë detyrën e tij.

"Po, e vërtetë, nesër nis aventura ime si tekniku i kombëtares shqiptare. Diçka që më bën të emocionohem dhe në fakt më mbushet me krenari dhe sigurisht që më bën të jem, të kem një stimul ekstra për të bërë akoma edhe më shumë përveç asaj se çfarë duhet të bëjmë. Sigurisht që janë gjërat shumë të qarta. Kemi pasur edhe disa vështirësi gjatë këtij grumbullimi, disa problematika të vogla. Kanë pasur të detyruar pushim për disa nga lojtarët, por ajo çfarë është e qartë dhe e sigurt, është se kush do të zbresë në fushë do të zbresë qartë, i plotë për atë çfarë duhet të bëjë për ndeshjen", u shpreh ai.

I pyetur nga gazetarët për gjendjen fizike të Kristjan Asllanit dhe ndikimin e mungesave në mesfushë në skemën taktike, tekniku sqaroi situatën e stërvitjeve dhe provat e bëra gjatë javës.

I fokusuar te zgjidhjet alternative, trajneri Maran theksoi se grupi i lojtarëve ka dhënë përgjigje pozitive.

"E vërtetë është që disa nga lojtarët nuk kanë pasur mundësi të stërviten vazhdimisht, por në fakt nga mungesa e disa lojtarëve kemi provuar disa gjëra të reja dhe kam marrë disa përgjigje shumë të mira. Asllani dhe Shehu të dy do të jenë në stërvitje sot dhe sigurisht që mbrëmjen e sotme do të kemi hapësirë edhe për të zgjedhur rrugën e duhur që do të ndjekim edhe për ndeshjen e nesërme. Kanë qenë disa ditë impenjative, por në fakt më kanë dhënë disa përgjigje shumë të mira dhe unë kam shumë besim që edhe nëse disa lojtarë nuk do të kenë hapësirë për të luajtur ndoshta 90 minuta, kjo na jep hapësirën për të zgjedhur edhe për të zbritur në fushë një skuadër e cila është e gatshme për të luftuar, për të bërë më të mirën", u shpreh trajneri Maran.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

15:41 Grupi Parlamentar i PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale të vendit: 100 bashki dhe 12 qarqe

15:36 BE zhblokon 6.6 miliardë euro ndihmë ushtarake për Ukrainën pas heqjes së vetos nga Hungaria

15:28 Vrasja e "Tanit të Rruzhdit", dalin pamjet e momentit të ekzekutimit

SHPËRNDAJE

ARTIKULLIN

15:23 Të shtënë me armë në Tiranë, policia jep detajet! Del emri i të plagosurit

15:18 Kurti: Zgjedhje të reja nëse Kuvendi nuk arrin të zgjedhë presidentin deri më 6 tetor

15:05 Ambasadori i ri i SHBA mbërrin në Tiranë, nesër ceremonia e dorëzimit të letrave kredenciale

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

SPORT

Festoi golin duke imituar një të shtënë arme, përjashtohet futbollisti i Izraelit (VIDEO)

Futbollisti i Izraelit, Sayed Abu Farchi, është përjashtuar për shkak të mënyrës se si e festoi golin e barazimit ndaj Austrisë, të enjten mbrëma. Austria...

12:25 | 25/09/2026

KOSOVË | SPORT

Trajneri i Irlandës "dorëzohet" pas humbjes ndaj Kosovës: Fitore e merituar

Trajneri i Irlandës, Heimir Hallgrímsson, nuk e ka fshehur zhgënjimin pas humbjes 1-0 ndaj Kosovës në ndeshjen hapëse të Ligës së Kombeve. Tekniku islandez e...

11:22 | 25/09/2026

SPORT

Muriqi vendos ndeshjen në fund, Kosova triumfon ndaj Irlandës

Kosova ka shënuar fitore 1-0 ndaj Irlandës në "Fadil Vokrri", falë golit të Vedat Muriqit në minutën e 84-të. "Dardanët" ishin dukshëm skuadra më kërkuese...

08:00 | 25/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.